



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 495/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Nenad Rashiç dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 20.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.495/2019 me datë 19.11.2019, e paraqitur nga subjekti politik koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, me të cilën ka kërkuar që të shpallet i pavlefshëm një fletëvotim në Vendvotimin 1830E/02D.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 19.11.2019, ka pranuar një ankesë Anr.495/2019 nga subjekti politik koalicioni NISMA-AKR-PD, në të cilën pretendon se me datë 18.11.2019, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë rinumërimit të votave në kutin e vendvotimit 1830E/02D, vëzhguesi i tyre ka vërejtur se 1 fletëvotim që i përket subjektit politik Stranka Demokratske Akcije (SDA) me nr.114 dhe një shkrim votimi ekziston brenda rubrikës së subjektit politik me numër 113 i cili i takon Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI), me të cilën është shpallur i vlefshëm nga zyrtarët e QNR-së.

Parashtruesi i ankesës thekson se bazuar në Doracakun e Procedurave të Votimit dhe Numërimit të KQZ-së, sipas shtojcës nr.8 (Mostër e fletëvotimit të Pavlefshëm), ky fletëvotim duhet të shpallet i pavlefshëm për arsye se është votuar në dy rubrika të subjekteve politike SDA dhe PAI.

Kërkojnë nga PZAP-i që ankesa e tyre të aprovohet në tërësi, këtë fletëvotim nga vendvotimi nr.1830E/02D ta shpallë të pavlefshëm dhe ta obligoj KQZ-QNR që këtë ta largoj nga votat e vlefshme dhe nga rezultati përfundimtar.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe vlerësimit të provave të bashkangjitura, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës konstatohet se në vendvotimin: 1830E/02D është shpallur nga ana e QNR-së, një fletëvotim i vlefshëm, për shkak se një shkrim votimi është i vendosur në dy rubrikat e subjekteve politike dhe është i qartë se cili subjekt është votuar. Si rezultat i këtyre konstatimeve QNR-ja, me rastin e rinumërimit e ka shpallur të vlefshme këtë fletëvotim.

Subjekti politik koalicioni NISMA-AKR-PD, si palë ankuese ka paraqitur ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së dhe nenit 8 par. 1 të Rregullores Zgjedhore NR. 06/2013, brenda afatit ligjor kur ka kërkuar nga PZAP-i, që këtë fletëvotim ta shpallë të pavlefshme sepse përbën paqartësi të qëllimit të votuesit se për cilin subjekt ka pas për qëllim të votoj.

Paneli, me rastin e pranimit të ankesës, ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, Paneli ka gjetur se nuk qëndron pretendimi i ankuesit se pa të drejtë një fletëvotim i gjetur në kutinë e vendvotimit 1830E/02D është shpallur i vlefshëm, pasi që nga ekzaminimi i të njëjtit ka rezultuar se nuk e përmbush asnjërin kriter të pa vlefshmërisë, pasi që shihet qartë qëllimi i votuesit pa marrë parasysh që preket rubrika tjetër, pikënisja e shënimit-votimit të votuesit është e qartë, është në përputhje me shtojcën numër 7, për mostrat e fletëvotimeve të vlefshme, mostra nr.9, të Doracakut të KQZ-së, dhe e njëjta duhet të llogaritet e vlefshme dhe rezultati i të njëjtës duhet t'i bashkëngjiten rezultatit përfundimtar të publikuar me datë 07.11.2019.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze”, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117 dhe nenit 118 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 495/2019 më datën 20.11.2019

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

